

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gani Avdiu, kryesues, anëtarët Ramë Hyseni e Burim Shala, (më tej kolegji) në kontestin e paditësve T.A. dhe L.A. nga Ferizaj, përmes përfaqësuesit ligjor F.A. (babai i paditëseve), të përfaqësuar nga F.Z., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Croatia Sigurimi” sh. A. me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga B.S., për kompensimin e dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr.395/2012 të datës 01.09.2014, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 10.07.2018 jep:

A K T G J Y K I M

Ndryshohet paragrafi I. i aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr.395/2012 i datës 01.09.2014, ashtu që gjykohet si vijon:

Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “Croatia Sigurimi” sh .a. me seli në Prishtinë, që paditëses T.A., në emër të kompensimit të dëmit jo material të pësuar si pasojë e aksidentit në komunikacion (i cili kishte ndodhur me dt. 20.06.2012), për dhembje fizike t’i paguajë shumën prej 4.500 (katërmijë e pesëqind) euro, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 12.000 euro.

Përtej shumës së gjykuar në paragrafin e mësipërm, kërkesëpadia e paditëses kundër të paditurës **refuzohet** në shumën prej 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro, si dhe kamatëvonesa në këtë shumë.

Ndryshohet afati i rrjedhjes së kamatëvonesës në aktgjykimin ankimor për pjesën vërtetuese të aktgjykimit të shkallës së parë si dhe për pjesën ndryshuese si në aktgjykimin e shkallës së dytë, dhe gjykohet, me kamatëvonesë e cila rrjedh nga data 01.09.2014, deri në pagesën definitive të borxhit.

Refuzohet ankesa e të paditurës si e pathemeltë dhe **Vërtetohet** pjesa e paragrafit I të aktgjykimit ankimor që ka të bëjë me shumën e gjykuar në emër të frikës dhe në emër të shëmtimit trupor për paditësen T.A..

Ndryshohet paragrafi II. i dispozitivit të aktgjykimit ankimor dhe gjykohet: Detyrohet e paditura KS “Croatia Sigurimi” që në emër të dhembjeve fizike paditëses L.A., t’i paguaj shumën prej 1.500 euro, ndërsa përtej shumës së gjykuar e në shumë prej 1.200 euro, kërkesëpadia e paditëses T.A., kundër të paditurës KS “Croatia Sigurimi” **refuzohet** si e pathemeltë, ndërsa për shumën e gjykuar në emër të frikës të cilën e paditura ka për detyrë t’ia paguaj paditëses T.A., ankesa e të paditurës **refuzohet**, kurse aktgjykimi ankimor i gjykatës së shkallës së parë, **vërtetohet**.

Paragrafi III i dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë që ka të bëjë me pjesën refuzuese të kërkesëpadisë së paditëseve kundër të paditurës, mbetet i pa ndryshuar.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktgjykimin C.nr.395/2012 të datës 01.09.2014, ka vendosur si vijon:

“Pjesërisht aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësve T.A. dhe L.A. nga Ferizaj, ashtu që obligohet e paditura Kompania e Sigurimeve “Croatia Sigurimi” me seli në Prishtinë, që paditësve në emër të kompensimit të dëmit jo material të pësuar në aksidentin e komunikacionit të datës 20.06.2012, t’ua paguaj shumat si vijojnë:

Për paditësen T.A., në emër të përjetimit të dhimbjeve fizike shumën prej 6.500.00 euro, në emër të zvogëlimit të përgjithshëm të aktivitetit jetësor shumën prej 25.000.00 euro, në emër të frikës së përjetuar shumën prej 2,500.00 euro, në emër të shëmtimit trupor shumën prej 4,000.00 euro, gjithsejtë shumën e përgjithshme prej 38,000.00 euro.

Për paditësen L.A., në emër të dhimbjeve fizike të përjetuar shumën prej 2,700.00 euro, në emër të frikës së jetuar shumën prej 625.00 euro, gjithsejtë shumën e përgjithshme prej 3,325.00 euro,

Të gjitha këto me kamatën e cila do të llogaritet nga dita e ndodhjes së aksidentit datë 20.06.2012, e deri në pagesën përfundimtare të saj, sipas lartësisë që llogarisin bankat vendore për deponimet një vjeçare të afatizuara nga qytetarët si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1,760.50 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësve për format e dëmit jo material, përtej shumave të aprovuara si në pikën (I) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ndërsa për format e dëmit material në tërësi .

Obligohen paditëset që gjykatës t’ia paguajnë taksën gjyqësore për aktgjykim në shumë prej 206,62 euro, pas pranimit të këtij aktgjykimi.”

Kundër këtij aktgjykimi e paditura KS “Croatia Sigurimi”, me dt. 29.10.2014, ka paraqitur një ankesë me të cilën ka kërkuar që aktgjykimi ankimor të ndryshohet, duke refuzuar kërkesëpadinë e paditësve kundër të paditurës, ose duke caktuar vlerat më të vogla për kompensim, ose i njëjti të prishet dhe çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim duke parashtruar këto shkaqe: *Shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.*

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit: Kolegji, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare, e në bazë të shkresave të lëndës vlerësoi se ka juridiksion që në procedurë sipas ankesës të shqyrtoi çështjen dhe të jep vendim. Kompetenca e saj në këtë rast bazohet në nenet 17 e 19 të Ligjit për Gjykatat, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 79/2010”).

Shqyrtimi i lejueshmërisë së ankesës: Kolegji para se të shqyrtoj themelësinë e ankesës paraprakisht në bazë të nenit 196 të LPK, shqyrton se ankesa është e pranueshme

në raport me atë se a është paraqitur brenda afatit ligjor, a është e lejueshme dhe a i përmban elementet e parapara me ligj.

Sa i përket afatit për paraqitjen e ankesës: Me nenin 176 të LPK, është përcaktuar se: Kundër aktgjykimit të dhënë në shkallë të parë, palët mund të bëjnë ankim brenda 15 ditësh, nga dita kur palëve u dorëzohet kopja e aktgjykimit përkatës.

Nga shkresat e lëndës (Fletë kthesat mbi dorëzimin e aktgjykimit të shkallës së parë palës ankuese si dhe datës së dorëzimit të ankesës me postë, e shënuar në zarfin përkatës) rezulton se ankesa është paraqitur para skadimit të afatit prej 15 ditësh, pra ajo është paraqitur brenda afatit ligjor.

Sa i përket lejueshmërisë: Ankesat janë paraqitur nga përfaqësuesit e palëve procedurale, që kanë interes juridik për paraqitjen e ankesave, nuk ka prova se ankuesit paraprakisht kanë hequr dorë nga e drejta e ankimit, se ankesat e paraqitura janë tërhequr, pra nuk përmbushen prezumimet ligjore të nenit 186.3 të LPK, që ankesa të jetë e palejueshme.

Sa i përket faktit se ankesa a është e plotë: Me vështrim në shkresa të lëndës dhe në kopje të ankesave konstatohet se ato i përmbajnë elementet e përcaktuara me nenin 178 të LPK, dhe mund të procedohet sipas tyre.

Kufijtë e ekzaminimit të aktgjykimit të shkallës së parë: Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, në kuptim të nenit 194 të LPK, ekzaminojë aktgjykimin e shkallës së parë brenda kufijve dhe shkaqeve të treguara në ankesë dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore dhe gjeti se:

Ankesa është pjesërisht e themeltë.

Sa i përket pjesës ndryshuese të aktgjykimit të shkallës së parë:

Kolegji, vlerëson se gjykata e shkallës së parë gjatë zbatimit të procedurës kontestimore, nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të nenit 182 par.2 nën par. b), g), j), k) dhe m) të LPK, për të cilat Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare, dhe nuk ekzistojnë shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 197 i LPK.

Nga gjendja në shkresa rezulton se gjykata e shkallës së parë ka marrë provat e përshkruara në arsyetimin e aktgjykimit ankimor dhe ka konstatuar gjendjen faktike si vijon:

Fakt kontestues mes palëve procedurale ishte se aksidenti a është shkaktuar vetëm me fajin e të siguruarit të të paditurës, apo në aksident kishin kontribut edhe paditëset.

Për vërtetimin e këtij fakti gjykata e shkallës së parë kishte marr mendimin e ekspertit të komunikacionit për të konstatuar faktet dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur aksidenti. Sipas mendimit të ekspertëve të komunikacionit ing. A.A., (punuar me 11.08.2012) dhe ekspertiza e ekspertit Y.K., (punuar me dt. 14.03.2013) rezulton se shkaktar i aksidentit ishte i siguruari i të paditurës, ndërsa paditëset nuk kanë kontribuar në shkaktimin e këtij aksidenti.

Pra, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se i siguruari i të paditurës është ekskluzivisht përgjegjës për shkakimin e dëmit ndërsa paditëset, nuk kanë kontribuar në shkakimin e dëmit e që rezulton se e paditura ka përgjegjësi juridiko-civile për kompensimin e dëmit të cilin paditëset e kanë pësuar në ngjarjen aksidentale të dt. 20.06.2012, pra janë përmbushur kërkesat ligjore nga neni 173 lidhur me nenin 178 dhe nenit 940 të LMD. Paditësja T.A., kishte pësuar lëndime të rënda trupore si pasojë e të cilave ka përjetuar dhembje fizike, frikë, zvogëlim të aktivitetit jetësor në shkallën 30%, si dhe shëmtim trupor të shkallës së mesme. Ndërsa paditësja L.A., kishte pësuar lëndime të lehta trupore si pasojë e të cilave ka përjetuar dhembje fizike dhe frikë, të gjitha këto të vlerësuara nga mjekët kompetent.

Pretendimet ankimore: Përfaqësuesi i të paditurës në ankesë ka pohuar se aktgjykimi ankimor është përfshirë me konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sepse në arsyetimin e tij nuk përmban konstatimin se cilit mjek apo grup të mjekëve ekspert i ka besuar me rastin e konstatimit të natyrës së lëndimeve trupore si dhe formave tjera të dëmit që paditëset i kanë pësuar si pasojë e ngjarjes aksidentale. Gjithashtu, nuk është vërtetuar drejtë dhe plotësisht fakti se cilët faktor kanë ndikuar në shkakimin e aksidentit ditën kritike.

Ekspertët e komunikacionit nuk kanë kompetencë që të vlerësojnë se çka përfaqëson shkelje, por shkelje të rregullave në komunikacion, por vetëm të identifikojnë elementet të cilat kanë ndikuar që të vijë deri te ngjarja e tillë aksidentale.

Lartësia e shumave të gjykuara nuk është në pajtim me praktikën gjyqësore në Kosovë, pra, ato janë jashtë çdo kriteri apo praktike gjyqësore duke pasur parasysh lëndimet të cilat paditëset i kanë pësuar në ngjarjen aksidentale si dhe pasojat

Kolegji, vlerëson se gjykata e shkallës së parë sipas barrës së provës, drejtë dhe plotësisht ka konstatuar gjendjen faktike, se paditëset si pasojë e aksidentit ditën kritike kishin pësuar lëndime të natyrës së rëndë përkatësisht të lehtë trupore, si pasojë e të cilave kishin përjetuar dhembje fizike dhe frikë të intensitetit dhe kohëzgjatjes së përcaktuar nga mjekët ekspert, gjithashtu paditësja T.A., kishte përjetuar dhembje shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor në shkallën prej 30% si dhe për shkak të shëmtimit trupor të shkallës së mesme dhe se aksidenti kishte ndodhur nga faji i të siguruarit të paditurës.

Mirëpo me rastin e vendimmarrjes, kolegji, vlerëson se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjykuar shumat si në dispozitivin e aktgjykimit ankimor, për paditësen T.A., për dhembjet fizike dhe dhembje shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, ndërsa për paditësen L.A., për shumën e gjykuar në emër të dhembjeve fizike, sepse shumat e gjykuara në këtë rast nuk bazohen në praktikën gjyqësore të krijuar nga Gjykatat e Kosovës, për këto forma të shpërblimit të dëmit. Për dhembje fizike të përjetuar si pasojë e lëndimeve të rënda trupore, gjykatat gjykojnë shumën për kompensim deri në 4.500 euro, për lëndime të lehta trupore deri në 1.500 euro, ndërsa për zvogëlim të aktivitetit jetësor për çdo 10% deri në 4.000 euro, natyrisht duke i pas për bazë edhe kriteret tjera si mosha, gjinia etj.

Kolegji, vlerëson se shumat e gjykuara si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së dytë janë adekuate me kriteret dhe qëllimin e përcaktuar me nenin 200 të LMD, si dhe në kuadër të kornizave të praktikës gjyqësore të krijuar nga Gjykata Supreme e Kosovës.

Këto shuma përfaqësojnë një satisfaksion adekuat që të dëmtuarat (paditëset) t'iu përballojnë më lehtë dëmet jo pasurore të pësuar, edhe pse këto forma të dëmit nuk mund të vlerësohen e as të kompensohen me para.

Me paragrafin 2 të nenit 200 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve ("Gazeta Zyrtare e RSFJ" nr. 29/78), si Ligj i zbatueshëm në Kosovë, në bazë të UNMIK Rreg. 1999/24, në momentin e shkaktimit të dëmit, (me tej LMD), është përcaktuar: "*Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material, si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se me të mos u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror*".

Pra, nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhembjeve të përjetuara si dhe frikës së të dëmtuarit, ashtu që kompensimi të përfaqësoj një lehtësim në përballimin e tejkalimit të pasojave të dëmit, që në këtë rast paditëset e kanë pësuar në ngjarjen aksidentale, e që përfaqëson edhe qëllimin e dispozitës së lart cituar ligjore.

Sa i përket vendimit të dhënë në aktgjykimin e shkallës së parë që ka të bëjë me kamatëvonesën ai ishte i bazuar në nenin 277 të LMD, sepse LMD i vitit 1978 ishte ligj i zbatueshëm në kohën e shkaktimit të dëmit, në këtë drejtim është krijuar edhe praktika gjyqësore e shprehur në vendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës të dhëna me procedurë sipas revizionit (P.sh Aktgjykimi Rev. nr. 359/2014 i dt. 16.12.2014).

Sa i përket paragrafit III të dispozitivit të aktgjykimin të shkallës së parë me të cilin është refuzuar kërkesëpadia e paditëseve për dëmin jo material dhe material, nuk ishte objekt i ekzaminimit në gjykatën e shkallës së dytë, sepse kjo pjesë e vendimmarrjes në aktgjykimin e shkallës së parë, nuk ishte goditur me ankesë.

Më sa u tha më lartë e duke u bazuar në nenet 200 e 201 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-PRISHTINË
CA.nr.4468/2014 dt. 10.07.2018

Kryesuesi i Kolegjit – gjyqtari
Gani Avdiu